

MARRËVESHJE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE

TË SHOQËRISË “A&A AIRPORT” SH.P.K.

ME

SHOQËRINË “RUNWAY 35” SH.P.K.

Sot, më datë 14/08/2022, në Tiranë, hartohet dhe nënshkruhet kjo Marrëveshje për bashkimin me përthithje të palëve si më poshtë:

Shoqërisë “A&A AIRPORT” Sh.p.k, me kapital themeltar 100.000,00 lek, me seli në Komuna Nikël, Rinas Krujë, Fshati Rinas, Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Durrës dhe shoqërisë “RUNWAY 35” Sh.p.k, me kapital themeltar 100.000,00 lek, me seli në Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Nikël, Rinas, Durrës. (këtu e në vijim referuar si “A&A AIRPORT” ose “Shoqëria Përthithëse”)

Në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit “Për Regjistrin Tregtar, kemi formuluar këtë projekt marrëveshje të bashkimit me përthithje ku shoqëria tregtare “RUNWAY 35” Sh.p.k. do të përthithet nga Shoqëria tregtare “A&A AIRPORT” Sh.p.k. (këtu e në vijim referuar si “RUNWAY 35” ose “Shoqëria e Përthithur”)

Shoqëria Përthithëse dhe Shoqëria e Përthithur janë referuar këtu e në vijim individualisht si “Pala” dhe së bashku si “Palët” ose “Shoqëritë e Bashkuara”

MEQENËSE

- A. “A&A AIRPORT” SH.P.K është pronar 100% i kapitalit të shoqërisë “RUNWAY 35” SH.P.K;
- B. A. “A&A AIRPORT” SH.P.K, si ortak i vetëm i “RUNWAY 35” SH.P.K, ka vlerësuar paraprakisht mundësi të ndryshme për racionalizimin e operacioneve, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë aktuale dhe të ardhshme, si edhe rendabilitetin e operacioneve të biznesit të të dy subjekteve. Pas këtij vlerësimit, shoqëria “A&A AIRPORT” Sh.p.k i propozoi bashkimin shoqërisë “RUNWAY 35” SH.P.K nëpërmjet një bashkimi me përthithje në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- C. Pas këtij propozimi, mbledhjet përkatëse të “A&A AIRPORT” Sh.p.k dhe “RUNWAY 35” SH.P.K, kanë vendosur të autorizojnë fillimine procedurave të bashkimit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje bashkimi;

1) Forma, emërtimi dhe selia e shoqërive pjesmarrëse

Shoqëria Tregtare “RUNWAY 35” SH.P.K., e cila në këtë operacion bashkimi do të jetë shoqëria e përthithur, rezulton me këto të dhëna:

- Shoqëria “RUNWAY 35” SH.P.K. është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në datën 21/05/2020.
- Forma e shoqërisë “RUNWAY 35” SH.P.K. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Emërtimi i shoqërisë është “**RUNWAY 35**” SH.P.K.
- Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza” Nikël, Rinas, Durrës.
- Ortak i Vetëm i shoqërisë është shoqëria “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k., e cila zotëron kapitalin themeltar në masën 100% të tij.
- Administrator i Shoqërisë është **Z. Aliona Zeqiri**
- Kapitali themeltar i shoqërisë para bashkimit me anë të përthithjes është 100.000,00 lek.

Shoqëria Tregtare “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k., e cila në këtë operacion bashkimi do të jetë shoqëria përthithëse, rezulton me këto të dhëna:

- Shoqëria “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k. është regjistruar si person juridik ne Qendren Kombetare te Biznesit me datë 16/04/2018.
- Forma e shoqërisë “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).
- Emërtimi i shoqërisë është “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k.
- Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Komuna Nikël, Rinas Krujë, Fshati Rinas, Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Durrës.
- Ortak i Vetëm i shoqërisë është shoqëria Zj. Alselda Kosturi cila zotëron kapitalin themeltar në masën 100% të tij.
- Administrator i Shoqërisë është Z. Adrian Kosturi dhe Znj. Aliona Zeqiri, ku secili ka kompetenca të pakufizuara që më vete të administrojë dhe përfaqësojë shoqërinë.
- Kapitali themeltar i shoqërisë para bashkimit me anë të përthithjes është 100.000,00 lek.

2) Motivet, qëllimet dhe kushtet e bashkimit

2.1 Motivi i bashkimit me përthithje është fakti që shoqëria “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k është 100% pronare e shoqërisë “**RUNWAY 35**” sh.p.k, të dyja shoqëritë kanë të njëjtin, objekt veprimtarie, pra investimin në pasuri të paluajtshme “*Zhvillimi, administrimi dhe kryerja e transaksioneve me pasuri të paluajtshme, përfshi projektimin, ndërtimin, qiradhënien e tyre dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me to*”. Gjithashtu për lehtësira në administrim si dhe plotësimin e të gjitha detyrimeve për operimin e aktivitetit, në këto kushte është motivuar që të realizohet bashkimi me përthithje të shoqërisë “**RUNWAY 35**” sh.p.k. nga ana e Shoqërisë “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k. Ortakët e shoqërive reciproke kanë interes ekonomik në parim që të realizohet ky proces i bashkimit me përthithje.

2.2 Qëllimi i bashkimit me përthithje është që të evitohen shpenzimet e tepërta që kryhen nga secila shoqëri në lidhje me administrimin ekonomik, pasi duke u bashkuar në një shoqëri të vetme arrihet si qëllim kryesor një efikasitet më e lartë e aktivitetit ekonomik financiar të këtij biznesi.

Në zbatim të nenit 220 të Ligjit për Shoqëritë, “**RUNWAY 35**” do të transferojë nëpërmjet bashkimit tërësisht të gjitha aktivitetet dhe pasivitetet e saj dhe ekzistenca më vete e “**RUNWAY 35**” shpk do të përfundojë. Shoqëria “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k do të jetë shoqëria Përthithëse dhe do të vazhdojë ekzistencën e saj nën emrin e saj të regjistruar dhe tregtar: “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k.

2.3 Kushtet e bashkimit me përthithje të Shoqërisë “**RUNWAY 35**” sh.p.k e cila do të përthithet nga shoqëria “**A&A AIRPORT**” Sh.p.k. janë si më poshtë vijon:

- a) Vendimi i Asamblesë së të dyja Shoqërive të Bashkuara e miratuar të paktën një muaj pas datës së publikimit të Draft-Marrëveshjes së Bashkimit në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 216.3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- b) Dhënia e miratimit ose konfirmimit të Bashkimit nga të gjitha Autoritetet në Shqipëri dhe realizimi i të gjitha njoftimeve të nevojshme të parashikuar nga legjislacioni në

fuqi, duke përfshirë por pa u kufizuar në Autoritetin e Konkurrencës në Shqipëri.

3) Caktimi dhe vlerësimi i aktivitetit dhe pasivitetit që është parashikuar t'i kalojë shoqërisë përthithëse.

- a) Tërësia e aktiveve dhe pasivëve të "RUNWAY 35" SHPK, të cilat do të transferohen tek "A&A AIRPORT" Sh.p.k, do të bazohen në Pasqyrat Financiare të "RUNWAY 35" SHPK dhe "A&A AIRPORT" Sh.p.k më 31 Dhjetor 2021 ("Data e Fundit e Konatibilitetit").
- b) Shoqëria "A&A AIRPORT" Sh.p.k do të aplikojë opsionin për konsolidimin retrospektiv, prandaj bilanci i hapjes pas bashkimit të "A&A AIRPORT" Sh.p.k do të paraqitet si rezultat i bashkimit të njëkohshëm të bilancit dhe gjëndjes së pasqyrës së të ardhurave të "RUNWAY 35" në "A&A AIRPORT" Sh.p.k duke filluar nga data 01/01/2022 ("Bilanci i Hapjes"). Çdo ndryshim, përmirësim dhe korrigjim i Bilancit të Hapjes i realizuar ndërmjet Datës së Fundit të Kontabilitetit dhe Datës së Mbylljes (nëse ka) do të raportohet dhe miratohet nga mbledhjet përkatëse të aksionerëve të të dy Shoqërive të Bashkuara.

4) Vijueshmëria dhe Aktivitetet e Transferuara

4.1 Nga Data e Mbylljes "A&A AIRPORT" Sh.p.k do të jetë pasardhësja, nëpërmjet bashkimit me përthithje e "RUNWAY 35" SHPK në çdo dhe të gjitha kontratat, aktet dhe marrëdhëniet në të cilat "RUNWAY 35" SHPK është palë, qoftë ekzistuese ose në të ardhmen. Rrjedhimisht, të gjitha aktivitetet dhe detyrimet, duke përfshirë të gjitha aktivitetet materiale dhe jo materiale, të gjitha tepricat kreditore, si dhe të gjitha pronat e paluajtshme, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhëniet të tjera juridike dhe pozicione juridike të cfarëdo lloji, detyrimet potenciale dhe të ardhurat në vazhdim dhe të kushtëzuara të "RUNWAY 35" SHPK, do të transferohen tek "A&A AIRPORT" Sh.p.k ("Aktivitetet dhe Pasivitetet e Transferuara"), duke marrë parasysh çdo ndryshim që ndodh deri në datën e mbylljes.

2.1. Aktivitetet dhe Pasivitetet e transferuara do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në sa më poshtë vijon:

- (i) Çdo dhe të gjitha aktivitetet dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, aktivitetet materiale dhe jo materiale, pa asnjë kufizim ose përjashtim, të cilat i përkasin ose do t'i përkasin "RUNWAY 35" SHPK ;
- (ii) Çdo kontratë qiraje, sigurimi, furnizimi, shitje, porosie, konsultimi, kontrata shërbimi dhe kontratat në të cilat "RUNWAY 35" SHPK është palë, qoftë të lidhura tashmë ose që janë aktualisht në proces negocimi;
- (iii) Çdo kredi, borxh, depozitë të çdo lloji të krijuar nga "RUNWAY 35" SHPK ;
- (iv) Çdo dhe të gjitha të drejtat që lidhen më ndonjë dhe të gjitha detyrimet e vendosura ndaj "RUNWAY 35" SHPK ;
- (v) Çdo kërkesë, mosmarrëveshje, padi dhe procedurë kundrejt çdo Autoriteti ku "RUNWAY 35" SHPK është palë;
- (vi) Çdo dhe të gjitha pasivitetet dhe detyrimet që i atribuohen "RUNWAY 35" SHPK, duke përfshirë detyrimet potenciale dhe detyrimet e ardhshme të "RUNWAY 35" SHPK të cilat kanë ndodhur tashmë;

- 2.2. Aktivet dhe pasivet tatimore të “RUNWAY 35” SHPK që rezultojnë në pasqyrat financiare të “RUNWAY 35” SHPK, në Datën e Fundit të Kontabilitetit do të transferohen në “A&A AIRPORT” Sh.p.k njësoj si çdo lloj tjetër i aktiveve dhe pasiveve.
- 2.3. “A&A AIRPORT” Sh.p.k do të marrë në zotërim të gjitha librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe të dhëna të tjera të biznesit që ruan dhe mban “RUNWAY 35” SHPK. “A&A AIRPORT” Sh.p.k. Gjithashtu do të marrë në zotërim çdo dhe të gjitha instrumentet dhe dokumentat e nevojshme për të paraqitur të drejtat që i janë transferuar asaj. “A&A AIRPORT” Sh.p.k do të ruaj librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe të dhënat e tjera të biznesit të “RUNWAY 35” SHPK përgjatë periudhës ligjore të ruajtjes.
- 2.4. Të gjitha regjistrimet, shënimet, titujt dhe/ose shënimet në lidhje me “RUNWAY 35” SHPK në Zyrën Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme ose ndonjë regjistër tjetër që mbahet nga çdo Autoritet do t’i transferohen “A&A AIRPORT” Sh.p.k në Datën e Mbylljes nëpërmjet Bashkimit me përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. “A&A AIRPORT” Sh.p.k do të jetë pasuesi i “RUNWAY 35” SHPK në çdo dhe të gjitha të drejtat, kompetencat dhe marrëdhëniet që kanë të bëjnë me “RUNWAY 35” SHPK dhe që rrjedhin nga dispozitat e akteve ligjore dhe /ose nënligjore. Çdo dhe të gjitha barrët, kolaterale ekzistuese dhe/ose garancitë e krijuara në favor të “RUNWAY 35” SHPK do të vazhdojnë të jenë të vlefshme, në favor të “A&A AIRPORT” Sh.p.k si pasardhës e “RUNWAY 35” SHPK dhe të zbatueshme sipas klasifikimit të tyre.
- 2.5. Me transferimin e të gjitha të drejtave, aktiveve dhe pasiveve të “RUNWAY 35” SHPK në “A&A AIRPORT” Sh.p.k, “A&A AIRPORT” Sh.p.k do të gëzojë të gjithë të drejtën për të ngritur kërkesa në lidhje me aktivet dhe ka detyrimin t’u përgjigjet të gjitha pretendimeve që palët e treta mund të ngrenë *vis-a-vis* Shoqërisë së Përthithur.

5) KUSHTET PËR REALIZIMIN E MBYLLJES

- 5.1 Përfundimi i transaksionit të Bashkimit të parashikuar në bazë të kësaj Marrëveshje është subjekt dhe kushtëzohet nga plotësimi dhe përmbushja e kushteve të mëposhtme përpara Mbylljes:
- i. Vendimi i Asamblesë së të dyja Shoqërive të Bashkuara e miratuar të paktën një muaj pas datës së publikimit të Draft Marrëveshjes së Bashkimit në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit në

përputhje me nenin 216.3të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

- ii. Dhënia e miratimit ose konfirmimit të Bashkimit nga të gjitha Autoritetet në Shqipëri dhe realizimi i të gjitha njoftimeve të nevojshme të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë por pa u kufizuar në Autoritetin e Konkurrencës në Shqipëri.

6) MBYLLJA

6.1 Mbyllja do të bëhet pranë zyrave të shoqërisë “A&A AIRPORT” Sh.p.k, sa më shpejt që të jetë e mundur, pas përmbushjes së kushtet paraprake për Mbylljen, ose në çdo datë tjetër që palët do të dakordësojnë në mënyrë reciproke;

6.2 Në ose përpara datës së Mbylljes, Palët do të realizojnë nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumentave të mëposhtme:

- i. Dorëzimin e vendimeve të mbledhjes së asamblesë së “A&A AIRPORT” Sh.p.k dhe “RUNWAY 35” SHPK ku miratohet Mbyllja e Transaksionit të Bashkimit, Marrëveshjes së Bashkimit, dhedokumentet përkatëse dhe/ose çdo dokument tjetër pararendës të kushteve, nëse ka;
- ii. Shkresat e dorëheqjes dhe/ose revokimit të administratorit (ëve) dhe/ose anëtarve të organeve drejtuese/përfaqesuese të “RUNWAY 35” SHPK.

6.3 Pas nënshkrimit dhe/ose dorëzimit të dokumenteve të parashikuara në nenin 6.2 më sipër, Palët do të nënshkruajnë Deklaratën e Mbylljes e cila dëshmon përmbushjen e çdo dhe të gjitha kushteve dhe detyrimeve të Palëve për efektivitetin e Bashkimit.

6.4 Bashkimi do të bëhet efektiv në datën e regjistrimit të Bashkimit në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin për Shoqëritë (“Data e Mbylljes”).

7 SHOQËRIA; TË DREJTAT DHE PËRFITIMET E VECANTA

7.1 Statuti ekzistues i shoqërisë “A&A AIRPORT” Sh.p.k, i ndryshuar, nëse është e nevojshme dhe i miratuar rregullisht, do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

7.2 Administratorët e shoqërisë “A&A AIRPORT” Sh.p.k në Datën e Mbylljes do të jenë Administratorët e Shoqërisë Përthithëse. Administratori i “RUNWAY 35” SHPK do të japë dorëheqjen dhe/ose do të revokohet në Datën e Mbylljes.

8 MBROJTJA E KREDITORIT

8.1 "RUNWAY 35" SHPK janë të mbrojtur në zbatim të nenit 221 të Ligjit për Shoqëritë.

9 PASOJAT PËR PUNONJËSIT

9.1 "RUNWAY 35" SHPK nuk ka asnjë punmarrës/punonjës, rrjedhimisht nuk ka edhe detyrime që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit.

9.2 "A&A AIRPORT" Sh.p.k do të jetë përgjegjëse për çdo dhe të gjitha detyrimet, përfshirë detyrimet e papaguara – në rast se në të ardhmen do të ketë pretendime.

10 ZGJIDHJA E KONTRATËS

10.1 Kjo Marrëveshje do të zgjidhet vetëm në bazë të miratimit me shkrim të të dyja palëve përpara Datës së Mbylljes.

11 LIGJI I ZBATUESHËM

11.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në të gjitha aspektet në përputhje me ligjet dhe Udhëzimet në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në rast të mosmarrëveshjeve Gjykata e Rrethit të Tiranës do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

12 TË NDRYSHME

12.1 Kjo Marrëveshje (së bashku me të gjitha dokumentet e përmenduar në të, ose të nënshkruara në datën e Mbylljes ose përpara saj) përbën tërësinë e Marrëveshjes dhe dakordësinë midis Palëve në lidhje me përmbajtjen saj dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet, kontratat ose angazhimet e mëparshme lidhur me këtë çështje.

12.2 Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë efektive nëse nuk është bërë meshkrim nga Palët. Adresat për komunikime ndërmjet palëve në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje do të kryhen në adresat dhe personat si më poshtë:

a) Për shoqërinë "A&A AIRPORT" Sh.p.k

Emër/Mbiemër: Adrian Kosturi, Aliona Zeqiri

Nr. Telefoni: +355 69 20 65 699

Adresa elektronike: info@aa-group.net

b) Për shoqërinë "RUNWAY 35" SHPK

Emër/Mbiemër: Aliona Zeqiri

Nr. Telefoni: +355 69 20 65 699

Adresa elektronike: info@aa-group.net

12.3 Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën Shqipe, në 4 kopje të njëjta.

“A&A AIRPORT” SHPK

“RUNWAY 35” SHPK

Përfaqësuar nga:



Adrian Kollari



Aliona Zeqiri

Administratoret

Përfaqësuar nga:



Aliona Zeqiri

Administrator